


30.05.2014  
20.05.2014  
*[Handwritten signature]*



REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MBZHR.A.U  
Nr. 2274 Prot.  
Datë 20.05.2014

REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTRIA E BUJQËSISË,  
ZHVILLIMIT RURAL DHE  
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE  
MINISTRI

Nr. 3: 25 Prot.

Tiranë, më 20.5.2014

**URDHËR**

Nr. 235, datë 20.5.2014

**PËR**

**KËF KESAT E GJURMUESHMËRISË TË PRODUKTEVE ME ORIGINË SHTAZORE**

Në r bështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, si dhe në zbatim të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008, "Për ushqimin", i ndryshuar,

**URDHËROJ**

1. Miratimin e rregullores "Për kërkesat e gjurmueshmërisë të produkteve me origjinë shtazore", sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohet Drejtoria e Sigurisë Ushqimore dhe Peshkimit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij urdhri.

Kur urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**  
*[Handwritten signature]*  
**EDMOND PANARITI**

# KËRKIMET E GJURMUESHMËRISË TË PRODUKTEVE ME ORIGJINË SHTAZORE

## Neni 1

### Lënda

Kjo rregullore, përcakton dispozitat për zbatimin e kërkesave të gjurmueshmërisë për operatorët e biznesit ushqimor në lidhje me ushqimet me prejardhje shtazore, të përcaktuara në ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008, "Për ushqimin", i ndryshuar.

## Neni 2

### Qëllimi

1. Kjo rregullore, zbatohet për produktet e papërpunuara dhe të përpunuara ushqimore, siç përcaktohet në ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008, "Për ushqimin", i ndryshuar.
2. Kjo rregullore, nuk zbatohet për ushqimet që përmbajnë të dy produktet me origjinë bimore dhe produkte të përpunuara me origjinë shtazore.

## Neni 3

### Kërkesat e gjurmueshmërisë

1. Operatorët e biznesit ushqimor, duhet të sigurojnë se informacioni i mëposhtëm në lidhje me dërgesat me ushqime me origjinë shtazore të jetë i disponueshëm për operatorin e biznesit ushqimor, nga cili është i furnizuar me ushqim, sipas kërkesës, për autoritetin kompetent:
  - a) një përshkrim i saktë i ushqimit;
  - a) vëllimi apo sasia e ushqimit;
  - b) emri dhe adresa e operatorit të biznesit ushqimor, nga i cili ushqimi është marrë;
  - c) emri dhe adresa e dërguesit të dërgesës (pronarit) nëse është i ndryshëm nga operatori i biznesit ushqimor, nga i cili ushqimi është marrë;
  - d) emri dhe adresa e operatorit të biznesit ushqimor, për të cilin ushqimi është dërguar;
  - e) emri dhe adresa e marrësit të dërgesës (pronarit), nëse është i ndryshëm nga operatori i biznesit të ushqimit, për të cilin ushqimi është dërguar;
  - f) një referencë për identifikimin e lotit, grumbullit apo ngarkesës si e përshtatshme;
  - g) datën e nisjes (ose dërgimit).

informacion që kërkohet në lidhje me gjurmueshmërinë e ushqimeve me origjinë shtetërore.

3. Informacioni i përmendur në paragrafin 1, të përditësohet në baza ditore dhe të mbahet në dispozicion të paktën deri sa mund të jetë e arsyeshme, mund të supozohet deri kur ushqimi të jetë konsumuar.

Kur kërkohet nga autoriteti kompetent, operatori i biznesit ushqimor të sigurojë informacion pa vonesë. Forma e përshtatshme, në të cilën informacioni duhet të vihet në dispozicion është në zgjedhjen e furnizuesit të ushqimit, për atë kohë sa informacioni i kërkuar në pikën 1 është i qartë dhe pa mëdyshje për të, si dhe të shikohet dhe nga operatori i biznesit ushqimor, nga i cili ushqimi është furnizuar.